

VENDIM
Nr.608, datë 12.9.2007

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË PËRRENJASIT TË KINOKLUBIT
TË KËTIJ QYTETI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “d”, 8 e 18 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Përrenjasit të objektit “Kinoklubi i qytetit”, me sipërfaqe të përgjithshme 493 m², në zonën kadastrale 2924, me numër pasurie 2/47, për zhvillimin e veprimtarive social-kulturore.

2. Bashkisë së Përrenjasit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Përrenjas, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

